



Prishtinë, 12.10.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1606_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2349_08_22** i dt.25.08.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **09.09.2022**;

në seancën e mbajtur më datë **12.10.2022** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin Xh. L., nga Komuna e Vushtrisë, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2349_08_22, i datës 25.08.2022.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 25.08.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2349_08_22 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit Xh. L., dhe e ka obliguar KESCO-n që ta korrigjojë faturën nr.101-DMI20S139010, datë 24.08.2020, dhe ta ngarkoj konsumatorin vetëm me taksën për kyçje në rrjet (40 EUR+TVSH).

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Ngarkesa me shërbimin prej 118.00 EUR është taksë për lidhje të re, sepse aplikuesi Xh. L., ka aplikuar për lidhje të re për herë të parë dhe i njëjti nuk ka pasur shifër të vjetër.
- Shifra DMI – 104066 ka qenë shifër e arkivuar në parcelën e njëjtë, në emër të N. L., dhe si e tillë i takon një personi tjetër dhe për një objekt tjetër banimi, i cili është shkatërruar gjatë luftës.
- KESCO konsideron që faturimi i shërbimit në vlerë prej 118 EUR është në harmoni me Metodologjinë e Taksave për Kyçje dhe në përputhje me Metodologjinë Tarifore të miratuar nga ZRrE.
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2349_08_22 i datës 25.08.2022 për konsumatorin Xh. L.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 25.08.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se ankuesi ka aplikuar për lidhje të re, pasi që i njëjti nuk ka pasur shifër të vjetër, Bordi i ZRrE thekson se pasi që ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës, si Aplikacionin për lidhje të re, të dt. 22.07.2020, Procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik të dt. 17.08.2020, Faturën e dt. 24.08.2020; Ankesën e konsumatorit në KESCO të dt. 23.09.2020; Përgjigjen e KESCO të dt. 17.11.2020 dhe Ankesën e konsumatorit në ZRrE të dt. 20.01.2021, ka gjetur se: pas kërkesës së konsumatorit, punëtorët e autorizuar të KEDS-it e kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe kanë vendosur njehsorin e ri elektrik nr.75158899 me gjendje të shpenzimit zero. Përveç të dhënave teknike, në këtë procesverbal është evidentuar se kyçja teknikisht është në rregull, dhe se njehsori vendoset në shtyllë. Është evidentuar po ashtu se, shifra e vjetër e arkivuar është DMI – 104066, në emër të N. L., e pasivizuar me datë 25.05.2007. Pra, ky pretendim si tillë është i paqëndrueshëm, sepse në rastin e konsumatorit në fjalë, ky kapacitet, është paguar më herët në shifrën DMI – 104066, andaj, nuk ka mbështetje që i licencuari KESCO ta obligoj konsumatorin, të paguaj kapacitetin i cili veçse ekziston dhe është paguar nga një konsumator i mëhershëm. Bordi thekson se, meqë kapaciteti ekziston, pra nuk ka nevojë, për investime shtesë të ndërmarrjes, për konsumatorin, ka mbetur për t'u paguar vetëm taksa për kyçje në rrjet, në vlerë prej 40 EUR, bashkë me TVSH, sipas procedurës lidhëse.

Nga analizimi që i është bërë faturës së dt. 24.08.2020, me të cilën është ngarkuar konsumatori me taksën për shërbime/lidhje e re, në vlerë prej 118 EUR, Bordi thekson se, në rrethana tjera, taksa për 60 EUR për Pëlqim Elektroenergjetik (20 EUR x 3kW) në sistemin tre fazor, do të duhej të aplikohet, sikur të mos ekzistonte kapaciteti aktual. Por që, në rastin e konsumatorit në fjalë, kapaciteti veçse ekziston, sepse, në të njëjtin objekt, ka ekzistuar një shifër e mëparshme (shifra DMI – 104066) në emër të konsumatorit N. L., por që e njëjta ishte pasivizuar me datë 25.05.2007, dhe një gjë e tillë vërtetohet nga Transaksionet e konsumatorit si në shkresat e lëndës dhe Rrjedha e Energjisë Elektrike Aktive.

Pretendimi tjetër se, shifra e arkivuar i takon një konsumatori tjetër dhe në një objekt tjetër banimi, si i tillë, është jo relevant, sepse, sipas ankesës së konsumatorit, Bordi ka gjetur se është fjala për shtëpinë e njëjtë, e cila ishte djegur gjatë luftës. Ritheksojmë faktin se, edhe po të ishte një objekt tjetër, përsëri, do të vlerësohej si argument i pambështetshëm, sepse, kemi të bëjmë me kapacitet ekzistues dhe rrjedhimisht, konsumatori nuk mund të ngarkohet dy herë që ta paguaj të njëjtën shumë.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit Xh. L., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.